



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04.Nr MI-19181 /14
Kaçanik, 26.06.2014

Ne bazë të nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/ L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2014 -Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës-drejtorit të Institucionit Edukativo- Arsimor dhe Aftësues , Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës rishpall :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

I. Për drejtor të Shkollave Filllore të Mesme të Ulët:

1. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Kadri Zeka “ Dubravë,
2. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ 7 Shtatori “Begracë,
3. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Dituria “Ivajë,
4. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Nazmi Osmani “ Elezaj,
5. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Ali Asllani” Doganaj, dhe
6. Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Agim Bajrami “Stagovë ,

II. Kushtet e Kontratës.

Paga mujore: koeficienti 7.8

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Është përgjegjës për organizimin e procesit mësimor dhe planin e punës,
- Është i obliguar të paraqes raport vjetor për veprimtarinë e shkollës dhe të jep informacione të tilla sa herë që kërkohet nga komuna dhe MASHT-i,
- Përgjigjet për të gjitha aktivitetet e arsimtarëve dhe personelit profesional dhe ndihmës të shkollës,
- Kujdeset për përfshirjen dhe vijimin e nxënësve në shkollë,
- Paraqet nevojën për arsimtar dhe personel tjetër të shkollës dhe merr pjesë në komisionin për zgjedhjen e tyre,
- Është përgjegjës edhe për çështje tjera të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi .

Periudha e kontratës zgjat katër vjet, me mundësi vazhdimi.

III. Kushtet e Konkursit:

a) Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendet e punës duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240ECTS/-4 vite të shkollimit universitar), nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënëseve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullave tjera ligjore,
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit ,
4. Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim, dhe
5. Të kenë më së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucionet e arsimit.

b) Për aplikim, kandidatët e interesuar duhet ti paraqesin këto dokumente:

1. Certifikatën e lindjes,
2. Diplomën e fakultetit për nivelin përkatës,
3. Dëshmi për përvojën e punës,
4. Portfolion profesionale (shih shtojcën G në Udhëzimit Administrativ të MASHT, nr 08/2014),
5. Letër referencë nga një institucion publik-kredibil,(që duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake),
6. Planin i zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilën ka konkurrar (se paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 font i shkronjave 12 arial,sipas udhëzimeve të MASHT-it,
7. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore, dhe
8. Dëshmi se nuk është nën hetime.

V. Afati dhe mënyra aplikimit.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores-Zyra e Pranimit, kati përdhes.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të shqyrtohen.

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike.

